

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 93/2015 “PËR TURIZMIN”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, ka për qëllim të promovojë Shqipërinë si destinacion turistik tërheqës autentik për vizitorët, duke mbështetur zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm.

Ndryshimet e propozuara kanë për qëllim të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve turistike të përmbushin kërkesat e turistëve, nëpërmjet rritjes në vazhdimësi të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në sektorin e turizmit, në një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt dhe duke respektuar nevojat e komuniteteve pritëse.

Mbrojtja e konsumatorëve është një nga çështjet që synohet të përmirësohet nga ndryshimet e propozuara.

Ky projektligj ka si qëllim reduktimin e informalitetit, duke parashikuar rregullime ligjore për kategori të reja të strukturave akomoduese, të cilat aktualisht operojnë në treg, por janë të paregjistruara dhe të pastandardizuara.

Ndryshimet janë orientuar drejt lehtësimit të procedurave të ushtrimit të veprimtarive turistike, me qëllim krijimin e një klime miqësore me biznesin, pa cënuar standardet e ofrimit të shërbimit.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij projektligji do të bëhet riorganizimi i institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit në varësi të ministrisë përgjegjëse të turizmit.

~~Ndryshimet e propozuara synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit përgjatë gjithë vitit dhe me shtrirje në të gjithë territorin e vendit, duke ofruar alternativa të tjera nëpërmjet zhvillimit të turizmit natyror dhe kulturor, përkrah atij të diellit dhe detit. Kjo mundëson zhvillimin e turizmit edhe në zona të thella malore, apo zona të tjera të cilat deri tani nuk janë të përfshira në hartën turistike të vendit, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive të reja turistike siç janë agroturizmi, veprimtaritë sportive rekreative, etj.~~

Përmirësimi i grumbullimit të të dhënave statistikore do të orientojë politikbërjen

në fushën e turizmit.

Gjithashtu, në ligjin ekzistues të turizmit është evidentuar mungesa e masave administrative për mosrespektimin e kushteve ligjore për ushtrimin e një sërë veprimtarish.

Në këtë projektligj synohet saktësimi dhe parashikimi i masave administrative për të gjitha veprimtaritë turistike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2023 dhe është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave 2021-2025 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Rishikimi i Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar, vjen si rrjedhojë e evidentimit të problematikave dhe mangësive si më poshtë:

- Operimi si struktura akomoduese në mënyrë informale i dhomave, apartamenteve dhe vilave, duke cënuar konkurrencën me subjektet formale, cilësinë e shërbimeve etj;
- Humbja e koherencës së disa funksioneve të parashikuara për t’u siguruar nga Degët Territoriale të Turizmit si dhe nevoja për përmirësimin e funksioneve dhe përgjegjësi të Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
- Mungesa në destinacion e një strukture koordinuese me pushtetin vendor, bizneset e grupet të interesit, në hartimin dhe zbatimin e planeve e programeve të turizmit;
- Nevoja e një procesi efektiv mbi propozimin dhe perzgjedhjen e projekteve- në fushën e turizmit për financim, duke synuar krijimin e një ambienti nxitës për kërkesë - propozime inovative nga çdo individ apo entitet;
- Domosdoshmëria për të ripërcaktuar, lehtësuar dhe definuar saktësisht disa procese që lidhen me certifikimin e udhërrëfyesve turistike, licencimin e

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar”.

operatorëve turistikë dhe agjencive të udhëtimit, parashikimin, përmirësimin dhe lehtësimin e kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë turistike si “Agroturizëm”, “Stacion plazhi” si dhe nevojën për transparencën e çmimeve dhe të procesit të ankimit nga çdo subjekt turistik që i nënshtrohet përcaktimeve të këtij ligji;

- Mungesa e mbledhjes së të dhënave statistikore të plota, të vërteta dhe në kohë reale;

- Mungesa e sigurimit të përgjegjesisë ndaj palëve të treta për subjektet që operojnë në turizëm;

- Nevoja për vendosjen e standardeve dhe rritjen e sigurisë në shtigjet që përdoren për ecje ose kalim përgjatë apo drejt vendndodhjeve të veçanta me interes turistik, me qëllim krijimin e eksperiencave rekreative.;

- Nevoja për të përmirësuar mënyrën e kontrollit të zbatimit të përcaktimeve ligjore nëpërmjet një tërësie masash për kundërvajtjet administrative nga ana e subjekteve.

Problematikat e identifikuara më lart, kërkojnë ndërhyrje ligjore që pasojnë me ndryshime dhe shtesa në ligjin 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.

• **Efektet e pritshme nga ndryshimet e propozuara:**

1. Reduktimi i informalitetit, vendosja dhe ruajtja e standardeve, mbrojtja e konsumatorit si dhe siguri i të dhënave statistikore për kapacitetet turistike dhe nga veprimtaritë e tjera turistike -referuar ligjit;
2. Krijimi i një klime të favorshme për subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike nëpërmjet lehtësirave proceduriale;
3. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm drejt zonave turistike natyrore, rurale dhe muzeale;
4. Rritja e sigurisë së turistëve;
5. Gjithëpërfshirja e pushtetit vendor, subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike e grupeve të interesit në hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve për zhvillimin e turizmit;
6. Zhvillimi i turizmit gjithëvjetor nëpërmjet nxitjes së veprimtarive turistike në zonat rurale, natyrore, muzeale e historike;
7. Përshtatja me Kodin e ri të Procedurave Administrative.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në zbatim të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është në harmonizim me legjislacionin në fuqi që rregullon aktivitetet e turizmit detar apo parashikimeve ligjore që lidhen me agroturizmin. Gjithashtu është në harmonizim edhe me objektivat e dokumentit të Strategjisë ndërsektoriale për turizmin.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* e BE, por është në harmoni me praktikat më të mira të vendeve të rajonit në fushën e turizmit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar parashikon disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, më konkretisht:

Në nenin 1 të projektligjit është parashikuar që kudo në përmbajtje të ligjit fjala “revokim/in” zëvendësohet me fjalën me “shfuqizim/in”, në kuadër të harmonizimit me Kodin e Procedurave Administrative.

Në nenin 2 të projektligjit, është parashikuar ndryshimi i përkufizimit të termit “Agjenci udhëtimi” dhe “person fizik dhe juridik”. Gjithashtu, në nenin 4 të ligjit bazë, janë shtuar përkufizimet e disa termave si: “Apartment”, “Bllok Apartamentesh”, “Vilë”, “Dhomë”, “Shteg turistik”, “Organizata e Menaxhimit te Destinacioneve (OMD)”, “Vrojtues plazhi”, “Hotel trashëgimi kulturore”, “Hotel i shpërndarë”, “Sipërmarrës turistik”, “Ujëra të brendshme”, “Zonë bregujore” dhe “Kalendari Turistik i Aktiviteteve Zbavitëse”, e cila, lind si nevojë e një vakumi ligjor në ligjin aktual.

Njësitë e vogla si: apartamente, dhoma, vila e të ngjashme me to, nuk janë objekt i ligjit aktual, ndërkohë që këto janë struktura të cilat ofrojnë akomodim për turistët. Parashikimi i tyre në ligjin e ri të turizmit do të reduktojë informalitetin dhe do të rrisë nivelin e standardit të shërbimit si dhe do të shërbejë në organizimin sa më të mirë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve si dhe grumbullimit të të dhënave statistikore.

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar”.

Përfshirja e këtyre strukturave si objekt i këtij ligji i është referuar modeleve të vendeve të rajonit, konkretisht Italisë dhe Malit të Zi.

Me qëllim zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, nxitjen e veprimtarive turistike në zonat rurale, është parashikuar përfshirja e konceptit të shtegut turistik, si dhe në vijim do të bëhet rregullimi ligjor, i cili do të parashikojë standardet e sigurisë së shtigjeve turistike. Për përfshirjen e shtegut turistik si definicion dhe rregullimin e tij është bashkëpunuar me ekspertë gjerman dhe austriak, me eksperiencë në hapjen dhe mirëmbajtjen e shtigjeve.

Organizata e Menaxhimit të Destinacionit (OMD) krijohet me synimin e gjithëpërfshirjes së grupeve të interesit, pushtetit vendor etj., në lidhje me hartimin dhe zbatimin e planeve të programeve të turizmit si dhe për të koordinuar të gjithë elementët përbërës të destinacionit turistik. Roli i OMD lidhet me menaxhimin e çështjeve socio-ekonomike, kulturore dhe mjedisore si: monitorimi i rreziqeve dhe mundësive drejtë qëndrueshmërisë, mbështetja e ofruesve të shërbimeve në zhvillim dhe zbatim, promovimi i qëndrueshëm i aseteve të destinacionit, marketingu dhe promovimi i produkteve turistike, marrëdhëniet me komunitetin etj.

Shtohet koncepti i vrojtuesit të plazhit, ujërat e brendshme dhe zona bregujore, me qëllim krijimin e standardeve bazë në ligjin e ri të turizmit, për të vijuar me rregullimin e posaçëm në aktet përkatëse nënligjore, në kuadër të rritjes së sigurisë si dhe përcaktimit të zonave të reja bregujore dhe të brendshme për ushtrimin e aktiviteteve të turizmit detar.

Nëpërmjet konceptit të shtuar të sipërmarrësit turistik, synohet nxitja dhe zhvillimi i aktiviteteve të reja në fushën e turizmit nga subjektet tregtare, si dhe organizimi sa më i mirë i këtij sektori.

Përfshirja e konceptit të Hotelit të Shpërndarë dhe Hotelit Trashëgimi Kulturorë vjen si rrjedhojë e nxitjes së zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm në zonat turistike rurale dhe muzeale, së bashku me procedurën për njohjen e fshatit tradicional turistik, duke rivitalizuar ndërtime të vjetra dhe duke i shndërruar ato në struktura akomoduese mikpritëse.

Për të gjitha aktivitetet argëtuese turistike dhe kulturore si dhe për të nxitur zhvillimin e turizmit gjithëvjetor, krijohet kalendari turistik i aktiviteteve zbavitëse, gjithashtu me qëllim informimin mbi të gjitha ngjarjet zbavitëse që

ndodhin në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe promovimin e destinacioneve në të cilat zhvillohen këto aktivitete.

Në nenin 3 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 8 të ligjit bazë, në të cilin përcaktohen institucionet përgjegjëse në fushën e turizmit, me qëllim riorganizimin e strukturave përgjegjëse në fushën e turizmit, në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe zbatueshmërisë së funksioneve të tyre. Për shkak të mungesës së efikasitetit janë shfuqizuar degët territoriale si institucione të listuara në nenin 8 të ligjit bazë, ndërkohë që dhe Inspektoriati i Turizmit do të jetë pjesë përbërëse e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Neni 4 i projektligjit, parashikon shfuqizimin e nenit 10 të ligjit bazë, konkretisht neni i degëve territoriale të shërbimit të turizmit, i cili nuk parashikohet si institucion përgjegjës në fushën e turizmit, sipas nenit 3 të projektligjit, për shkak të mungesës së efikasitetit dhe produktivitetit në fushën e turizmit.

Në nenin 5 të projektligjit, është parashikuar shtimi i nenit 11/1 pas nenit 11 të ligjit bazë në kuadër të krijimit të një sistemi statistikor të unifikuar dhe gjithëpërfshirës, i cili do të grumbullojë të dhëna nga subjekte të ndryshme, si dhe do të krijohet Këshilli Ndërinstitucional për Sistemin e Statistikave. Duke qenë se do të jenë disa institucione të përfshira në procesin e përcjelljes së të dhënave statistikore, Këshilli do të ketë përbërje ndërinstitucionale për një koordinim dhe bashkëpunim sa më efikas. Institucioni përgjegjës për drejtimin e këtij Këshilli do të jetë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Drejtoria e statistikave pranë kësaj ministrie do të shërbejë si sekretariat teknik. Gjithashtu në këtë nen parashikohen detyrat konkrete të KNST.

Neni 6 i projektligjit, parashikon ndryshimin e nenit 14 të ligjit bazë, ku ripërcaktohen funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, në kuadër të ristrukturimit të saj dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 298/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit" i ndryshuar. Nëpërmjet funksioneve dhe kompetencave të reja, zgjerohet roli promovues i saj duke qenë institucioni kyç për promovimin e ngjarjeve kulturore, artistike si dhe duke patur nën kompetencë organizimin e aktiviteteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare. AKT do të jetë përgjegjëse për ecurinë e kalendarit turistik të aktiviteteve zbavitëse, në kuadër të zhvillimit të turizmit gjithëvjetor si dhe promovimit të destinacioneve të ndryshme turistike. Gjithashtu, forcohet roli i AKT në aspektin financiar si një institucion që krijon të ardhura dytësore nga subjekte të interesuara për promovim, me qëllim nxjerrjen e përfitimeve financiare por gjithashtu edhe financimin e projekteve të ndryshme në fushën e turizmit, që rrjedhimisht çojnë në promovimin dhe zhvillimin e turizmit kombëtar.

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar".

Në nenin 7 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i pikës 1, të nenit 15, të ligjit bazë, ku shtohen kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit duke përfshirë në strukturën përbërëse të tij edhe Inspektoriatin e Turizmit. Kjo bëhet me qëllim rritjen e rolit monitorues të AKB si institucioni përgjegjës për zonën bregujore të Republikës së Shqipërisë, me synim rritjen e sigurisë së turistëve vendas dhe të huaj.

Në nenin 8 të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i nenit 16 i ligjit bazë mbi Inspektoriatin në fushën e turizmit, duke qenë se kjo strukturë kalon si pjesë përbërëse e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Në nenin 9 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 17 i ligjit bazë, në të cilin, përcaktohen qartësisht kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, duke përthithur edhe kompetencat që dikur përfshiheshin tek Inspektoriati i Turizmit, Gjithashtu, specifikohet roli monitorues i AKB si institucioni kyç që do të jetë përgjegjës për kontrollin e zonës bregujore për pastrimin gjatë sezonit turistik. Për të rritur efikasitetin e pastrimit të kryer nga njësitë e qeverisjes vendore gjatë sezonit turistik, AKB do të shërbejë në plotësim të këtij shërbimi. Përveç të tjerash AKB do të jetë përgjegjëse edhe për nxitjen e investimeve në zonën bregujore, në kuadër të organizimit sa më të mirë të procesit të koordinimit, monitorimit, kontrollit dhe pastrimit të zonës bregujore, me qëllim pasjen e një sezoni turistik sa më të suksesshëm dhe në kuadër të menaxhimit më të mirë të mbetjeve gjatë këtij sezoni.

Në nenin 10 të projektligjit, parashikohet që në shkronjën “c” të pikës 2, të nenit 20, të ligjit bazë togfjalëshi “ ministrin dhe AKT-në,” zëvendësohet me togfjalëshin “ministrinë përgjegjëse për turizmin”, për arsye se ministria përgjegjëse për turizmin është institucioni qendror në të cilin Komiteti duhet të raportojë, ndërkohë që AKT nuk ka kompetenca që lidhen me Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit.

Neni 11 i projektligjit, parashikon shtimin e nenit 28/1, pas nenit 28 të ligjit bazë me qëllimin miratimin e rregullores për strukturimin dhe standardizimin e shtigjeve turistike, duke rritur në këtë mënyrë sigurinë për turistët si dhe duke nxitur promovimin dhe veprimtaritë turistike në zonat rurale. Kjo realizohet në kuadër të zhvillimit të turizmit gjithëvjetor dhe promovimit të zonave rurale.

Në nenin 12 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 31 të ligjit bazë, në të cilin përcaktohen se cilat janë projektet që financohen, skema dhe procedura e financimit. Gjithashtu, shtohet si iniciator projektsh Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit.

Ky ndryshim propozohet me qëllim nxitjen e zhvillimit të turizmit, nëpërmjet financimit të projekteve që nxisin dhe zhvillojnë më tej vendin.

Në nenin 13 të projektligjit, parashikohet shtimi i neneve 31/1, 31/2 dhe 31/3, pas nenit 31 të ligjit bazë, ku përcaktohet mënyra sesi kryhet miratimi i projekteve dhe

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar”.

veprimtarive në fushën e turizmit nga ministria përgjegjëse për turizmin, Agjencia Kombëtare e Turizmit, si dhe krijimi i kolegjiut në ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe AKT. Kolegjiutet do të kenë si funksion përzgjedhjen e projekteve duke mbajtur në vëmendje vlerat promovuese, sociale dhe ekonomike të tyre, në funksion të zhvillimit të turizmit. Fokusi do të jetë tek nxitja e promovimit turistik kombëtar dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.

Në nenin 14 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i shkronjës "a" të nenit 33/1, në funksion të qartësisë së kushtit që duhet të plotësohet nga subjektet, që aplikojnë për statusin "Investitor në strukturë akomoduese 4 ose 5 yje", status special.

Në nenin 15 të projektligjit, parashikohet që në fjalinë e parë të pikës 5, të nenit 35 të ligjit bazë, fjala "mund" shfuqizohet, pasi Këshilli i Ministrave është institucioni kompetent, që vendos mbi transferimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në funksion të projekteve investuese në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Në nenin 16 të projektligjit, parashikohet që pas shkronjës "ë" të nenit 43 të ligjit bazë, të shtohen kategoritë e strukturave akomoduese, konkretisht "f" "Apartament", "g" "Bllok apartamentesh", "gj" "Vilë", "h" "Hotel Trashëgimi Kulturore", "i" "Hotel i shpërndarë" dhe "j" "Dhomë", kjo për arsye se këto struktura akomoduese nuk janë objekt i ligjit bazë, ndërkohë që janë struktura që ofrojnë aktualisht akomodim për turistët. Përfshirja e tyre në ligjin e ri të turizmit do të reduktojë informalitetin, do të rrisë nivelin e standardit të shërbimit si dhe do të shërbejë në organizimin sa më të mirë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve si dhe grumbullimit të të dhënave statistikore.

Në nenin 17 të projektligjit, parashikohet shtimi i nenit 43/1, pas nenit 43 të ligjit bazë, në të cilin përcaktohet procedura e kategorizimit të strukturave akomoduese, zbatim i së cilës do të sjellë reduktim të informalitetit duke nxitur strukturat akomoduese aktuale dhe të reja të kategorizohen dhe të përfitojnë lehtësirat fiskale që legjislacioni ofron për subjektet e kategorizuara. Shtimi i këtij neni ka si qëllim edhe grumbullimin e të dhënave statistikore, vendosjen e standardeve si dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

Heqja e afatit të certifikatës së kategorizimit rrit qëndrueshmërinë e këtyre strukturave si dhe lehtëson procedurën e certifikimit të strukturave.

~~Në nenin 18 të projektligjit, parashikohen ndryshime në nenin 45 të ligjit bazë, konkretisht:~~

- ~~- Ndryshimi i pikës 1, në të cilën përcaktohen klasat e kategorive të strukturave akomoduese, me qëllim diferencimin e tyre;~~
- ~~- Shfuqizimi në pikën 3 i afatit për aplikim për rinovim me qëllim lehtësimin e procedurës;~~

~~Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar".~~

- Shfuqizimin e pikës 10, me qëllim gjithëpërfshirjen në këtë proces klasifikimi të të gjitha objekteve të akomodimit që përdoren për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese.

Në nenin 19 të projektligjit, parashikohet të shtohet neni 45/1 pas nenit 45 të ligjit bazë, në të cilin përcaktohen standardet bazë për të ushtruar veprimtarinë e agroturizmit dhe realizohet rregullimi i përgjithshëm ligjor i kësaj veprimtarie, duke e përfshirë në ligjin për turizmin.

Në nenin 20 të projektligjit, parashikohet zëvendësimi i fjalëve operatorëve të udhëtimit” me fjalët “operatorëve turistik” në shkronjën “b” të nenit 47 të ligjit bazë.

Në nenin 21 të projektligjit, parashikohet që në shkronjën “c”, të pikës 2, të nenit 48 të ligjit bazë, për të lehtësuar procedurat për ushtrimin e veprimtarive turistike të agjencive të udhëtimit, togfjalëshi “*të zotërojë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve ose dëshmi kualifikimi profesional, në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit*”, zëvendësohet me “*të ketë përfunduar arsimin e mesëm*”;

Në nenin 22 të projektligjit, parashikohet që në shkronjën , “c”, të pikës 2, të nenit 51 të ligjit bazë, për të lehtësuar procedurat për ushtrimin e veprimtarive turistike të operatorëve turistikë, pas togfjalëshit “*ciklit të parë të studimeve*” të shtohet togfjalëshi “*ose të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale*”.

Në nenin 23 të projektligjit, është përshtatur terminologjia me legjislacionin europian për paketat e udhëtimit, duke zëvendësuar fjalën “*konsumator*” me “*udhëtar*”.

Gjithashtu, parashikohen të shtohen shkronjat “p” dhe “q”, pas shkronjës “o” të nenit 54 të ligjit bazë mbi dhënat për kontratën bazë me konsumatorin, në kuadër të një mbrojtjeje sa më të mirë të tij, si dhe në përputhje me ligjin nr.9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar.

Në nenin 24 të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i nenit 55 të ligjit bazë.

~~Në nenin 25 të projektligjit, parashikohen ndryshime në nenin 57 të ligjit bazë, konkretisht:~~

~~- Shtimi i pikës 1/1 pas pikës 1, i cili qartëson hapat që ndiqen nga udhërrëfyesit turistikë përpara se të certifikohen me qëllim rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe ruajtjes së standardeve.~~

~~- shfuqizimi në shkronjën “a” të pikës 5, i fjalëve “*adresën e udhërrëfyesit*”~~

~~Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar”.~~

turistik", për të shmangur ndryshim të herë pas hershëm të certifikatës.

- Ndryshimin e pikës 6, në mënyrë që certifikatat e udhërrëfyesve turistik të jenë pa afat, me qëllim krijimin e lehtësirave gjatë ushtrimit të aktivitetit nga ana e tyre.

Në nenin 26 të projektligjit, parashikohen ndryshime në nenin 58 të ligjit bazë, konkretisht në shkronjën "a" dhe "b" me qëllim saktësimin e elementëve përbërës të dokumentit identifikues të udhërrëfyesit turistik si dhe qartësimin e përmbajtjes së nenit 58 të ligjit bazë.

Në nenin 27 të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i nenit 59 të ligjit bazë, duke qenë se me ndryshimet e reja certifikata e udhërrëfyesve turistikë do të jetë pa afat.

Në nenin 28 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 60, në të cilin ministria përgjegjëse për turizmin ndërmerr një rol kyç për miratimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesve turistikë si dhe duke miratuar rregulloren mbi programet e kualifikimit të tyre, me qëllim unifikimin dhe njëhësimin e këtyre programeve, shmangien e abuzimeve dhe rritjen e cilësisë të ofrimit të shërbimit nga na e udhërrëfyesve turistikë.

Në nenin 29 të projektligjit, parashikohet shtimi i një pike 1/1 tek neni 60, ku rregullohet veprimtaria e transportuesit turistik nëpërmjet kontratës së shërbimit midis operatorit turistik dhe transportuesit.

Në nenin 30 parashikohet ndryshimi i nenit 64 të ligjit bazë, në të cilin përcaktohen qartësisht kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, me qëllim eliminimin e problematikave të lindura nga mospërputhja e parcelave të stacioneve të plazhit me hartat përkatësete miratuara nga organet kompetente. Gjithashtu, synon informimin e pushuesve dhe rritjen e standardeve të sigurisë së jetës dhe shëndetit në plazhe.

Në nenin 31 të projektligjit, parashikohet të shtohet neni 64/1, pas nenit 64 të ligjit bazë, i cili përfshijë detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike, dhe cdo strukture akomoduese dhe stacion plazhi, me qëllim rritjen e standardeve të shërbimit, sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta, si dhe mbrojtjen dhe informimin e konsumatorëve.

~~Gjithashtu në këtë nen parashikohen edhe detyrime për sipërmarrjet turistike të cilat i ofrojnë shërbimet online.~~

Në nenin 32 të projektligjit, parashikohet të ndryshohet neni 66 i ligjit bazë, ku përcaktohet me qartë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore, periodiciteti i raportimeve dhe zgjerohet fusha e subjekteve të detyruara për të

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar".

raportuar të dhënave statistikore sa më sakta dhe në kohë reale.

Në nenin 33 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i pikës 2, të nenit 68, të ligjit bazë ku përcaktohet qëllimi i bashkëpunimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, me ministrinë përgjegjëse për turizmin, për ruajtjen e standardeve të shërbimit të ofruar nga sektori i turizmit, si dhe plotësimin e nevojave të tregut.

Në nenin 34 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 71 të ligjit bazë, në të cilin janë rishikuar shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, në mënyrë që të sigurohet zbatim i kuadrit ligjor dhe ndërgjegjësimit nga ana e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike.

Në nenin 35 të projektligjit, parashikohet/n organi/et përgjegjës/e për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe afati i miratimit të tyre.

Në nenin 36 të projektligjit, parashikohet hyrja në fuqi e tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për zbatimin e këtij ligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Gjatë procesit të hartimit të projektligjit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Ministren e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit kanë organizuar disa tryeza konsultimi me grupet e interesit, konkretisht:

- Subjekte që ushtrojnë veprimtari si struktura akomoduese – 20.09.2023
- Subjekte që ushtrojnë veprimtari si restorante- 20.09.2023
- Operatorë turistikë dhe agjenci udhëtimi – 21.09.2023
- Udhërrëfyes turistik – 22.09.2023
- Sektorin akomodues – 22.09.2023
- Takim me bizneset e turizmit për lehtësimin e shërbimeve, me prezencën e Kryeministrit – 03.10.2023.

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar".

Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me lehtësimin e procedurave, të ushtrimit të veprimtarisë, përmirësimin të infrastrukturës etj. Sugjerimet e sipërmarrjeve janë konsideruar gjatë hartimit të projektligjit. Gjithashtu, projektligji është hedhur për konsultim në regjistrin elektronik të konsultimeve publike në datë 3.10.2023 deri më datë 31.10.2023, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Për këtë projektligj kanë shprehur komente: Active Albania; Unioni Turistik Shqiptar; Shoqata e Agroturizmit Shqipëri; Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant; Dhoma Amerikane e Tregtisë, Shoqata Shqiptare e Turoperatoreve & Agjencie Turistike dhe kompania e sigurimit SIGAL, ku:

Shoqata Active Albania ka sugjeruar njohjen automatikisht të udhërrëfyesit e rafting, e klasës së IV e më sipër, të cilët e kanë marrë certifikatën e rafting në një vend të Bashkimit Europian në mënyrë që ata të vijnë e të punojnë edhe në Shqipëri sipas nevojës, koment i cili nuk është marrë në konsideratë, pasi nëpërmjet këtij projektligji synimi është nxitja e tregut të punës vendas në fushën e turizmit.

Unioni Turistik Shqiptar ka sugjeruar që në përkufizimin e termit “Agjenci udhëtimi” të përcaktohet numri i personave në grup/minigrup, maximumi deri në 9 persona. Ky sugjerom nuk u mor në konsideratë pasi përcaktimi i numrit të personave në grup është një kriter tejet kufizues. Ndërkohë që sugjerimi që termi “Agjenci udhëtimi” është përkufizim shumë i gjërë në krahasim me kompetencat e vërteta të një agjencie, u mor në konsideratë dhe u reflektua në riformulimin e këtij termi. Edhe propozimi për riformulimin e termit “Operatorëve të udhëtimit” është marrë në konsideratë dhe është reflektuar. Sa i përket komentit për kufizimet në hapësirën e mjedisit të punës dhe shtim të stafit me më shumë punonjës të kualifikuar, sqarojmë se nuk u mor në konsideratë pasi këto kritere janë kufizuese dhe për më tepër, në ditët e sotme ku të gjithë po orientohen drejt aplikimeve online and remote ëork. Po ashtu, vleresohet se nuk është kompetence e MTM, por e MSHMS. Sugjerimi për ndarjen në dy kategori të operatorëve turistikë në outgoing dhe incoming nuk u mor në konsideratë pasi ky ndryshim sjell detyrimin për pajisjen me licencë të posacme për këto kategori operatorësh. cka do të kërkojë ndryshim të ligjit për licencat si dhe VKM përkatëse. Sugjerimi për të përfshirë kritere më shtrënguese të arsimit, si diploma universitare e ciklit të parë të studimeve, eksperiencia etj, nuk u mor në konsideratë kriteri aktual i ligjit nuk ul standartin e turizmit, përkundrazi i nxit më shumë të rinjtë ti drejtohen shkollave profesionale. Shembull, ndjekja e nje shkolle profesionale në fushën e turizmit dhe marrja e formimit të duhur nuk e ul standartin por e rrit atë.

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar”.

Sa i përket sugjerimit për rivlerësimin e nenit 52 të ligjit bazë, ku përcaktohen rastet e ndërprerjes së licencës, sqarojmë se kërkesa për heqjen e licencës për operatorët që ushtrojnë veprimtari sezonale është abuzive dhe e tepërt, ndaj nuk është marrë në konsideratë. Përsa i përket komentit në lidhje me tarifat e garancisë së sigurisë, sqarojmë se nuk është shfuqizuar po është parashikuar në nenin 64/1. "Detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike". Sugjerimi për përcaktimin e vlerës së kontratës së sigurimit nuk u mor në konsideratë pasi ky përcaktim nuk mund të kryhet nga ne, por i referohemi parashikimeve të ligjit "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Po ashtu, përcaktimi i vlerave financiare kryhet bazuar në ekonominë e tregut. Duke parë dhe nivelin e inflacionit, nuk propozohet përcaktimi i aforfe i këtyre vlerave. Lidhur me sugjerimin që inspektorati në fushën e turizmit nuk duhet të shfuqizohet, sqarojmë se ky inspektoriat nuk është shfuqizuar, por kjo strukturë ka kaluar si pjesë përbërëse e AKB-së, në kuadër të ristrukturimit në agjenci rajonale. Për analogji, edhe inspektorati i mjedisit është pjesë e AKM, pra nuk ekziston si strukturë më vete. Përsa i përket propozimit për rishikimin e nenit 63, sqarojmë se u mor në konsideratë.

Shoqata e Agroturizmit Shqipëri ka dhënë sugjerimë që lidhen me nenin 45/1, në pikën dy të tij:

së pari: të shtohet afati i rinovimit të paracertifikates. Paracertifikata të rinovohet cdo 6 muaj në menyre qe kontrolli i kryerjes se veprimtarise së agroturizmit të mund te monitorohet;

së dyti, të shtohet: anëtare në komisionin e dhënies se paracertifikates/ certifikatës të jenë pjestare te shoqates se agroturizmi. Sqarojmë se këto sugjerimë nuk janë marrë në konsideratë, , pasi qëllimi i projektligjit është lehtësimi dhe nxitja e aktivitetit të Agroturizmit dhe vendosja e kushteve të tilla ka karakter pengues. Po ashtu, përfshirja e pjesëtarëve të shoqatës në komision cënon ndershmërinë në vendimmarrje.

Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant ka sugjeruar rishikim të përkufizimit 66, tek neni 4, të projektligjit mbi "sipërmarrjet turistike"; rishikim të nenit 8, pasi shprehet plotësisht kundër bashkimit të AKB së me Inspektoriatin, si dhe të nenit 11/1, që lidhet me Këshillin Ndërinstitucional për Statistikat, sugjerime të cilat nuk janë marrë në konsideratë.

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar".

Dhoma Amerikane e Tregtisë ka sugjeruar përfshirjen paraprake të grupeve të interesit që veprojnë në sektorin e turizmit, pasi do të kishte qenë me vlerë për përmbajtjen e propozimeve të sugjeruara si dhe reflektimin e problematikave kryesore që biznesi ndesh në praktikë; Gjithashtu, një nga problematikat kryesore që vërehet në këtë projektligj është që nuk ka asnjë parashikim në lidhje me praktikat apo instrumentat digjitale që institucionet (qoftë Ministria qoftë AKT) do të përdorin për të implementuar dhe ndjekur zhvillimet dhe gjurmimin e të dhënave, transparencës, duke sugjeruar që shumë shërbime duhet të jenë të aksesueshme në e-albania. Gjithashtu ka dhënë komente mbi paqartësinë e Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit (OMD) dhe cilat janë kriteret e përzgjedhjes së përbërjes së saj. Sqarojmë se sugjerimet e Dhomës Amerikane të Tregtisë janë vlerësuar dhe argumentuar sipas tabelës së raportit të konsultimeve publike.

Sa i përket sugjerimeve të **Shoqatës Shqiptare të Turoperatoreve & Agjencive Turistike** që lidhen me detajimin e perkufizimit të termit “operator turistik” në dy grupe, rivlerësimin e neneve 21 dhe 22 sa i përket kriterit të arsimimit; neneve 23 dhe 30 të projektligjit, sqarojmë se detajimet dhe vlerësimet e sugjerimeve të dhëna janë pasqyruar tek tabela e konsultimeve, që i bashkëlidhet praktikës së këtij projektligji.

Kompania e sigurimit SIGAL ka bërë disa sugjerime që lidhen me detyrimet e sipërmarrjeve turistike për ekspozimin e kontratës së sigurimit në një vend të dukshëm për publikun. Ky sugjerim është pranuar dhe reflektuar në projektligj. Gjithashtu, është sugjeruar përcaktimi i limitit minimal të përgjegjësisë për sigurimin e përgjegjësisë civile. Ky sugjerim nuk është marrë parasysh pasi procedura për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta do të kryhet në bazë të legjislacionit për sigurimet dhe risigurimet, i cili i parashikon këto limite.

Projektligji do t'u dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrin të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministrin të Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrin të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrisë së Brendshme, si dhe Agjencisë për Mbeshtetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar”.

Miratimi i këtij projektligji nuk parashikon të sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Parashikohet të ketë kosto të shtuara për bizneset, që ushtrojnë veprimtari turistike për shkak të detyrimit për kontratën e sigurimit, kosto e cila llogaritet të arrijë vlerën 6 milionë lekë në vitin e parë pas miratimit të ligjit, pra në total sipas opsionit 2, parashikohet që kostot të jenë në vlerën 6 milionë lekë.

Gjithahstu parashikohet të sjellë të ardhura buxhetore, të cilat do të sigurohen nëpërmjet masave të reja administrative, që nuk ishin parashikuar në ligjin ekzistues. Rritja vlerësohet në masën 10-15% në krahasim me vitin 2023.

Projektligji parashikon rritjen e shpenzimeve të subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike, për zërin e sigurimit të përgjegjesisë ndaj palëve të treta, e cila është bërë detyruese. Konsumatori, për dëmet e shkaktuara nga pakujdesitë e subjekteve turistike, do të dëmshpërblehet, në përputhje me kontratat e sigurimit të sipërpërmendura.

Vlerësimi financiar i ndikimit të këtij projektligji do të jetë i parashikuar në mënyrë të detajuar në dokumentin e RIA-s.

MINISTRI I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi: E. Tumani, Specialist

I. Çela, Përgjegjës Sektorial

Konfirmoi: A. Baze, Drejtor

E. Tarelli, Drejtor

Aprovoi: H. Duro, Drejtor i Përgjithshëm

A. Karaja, Drejtor i Përgjithshëm

Miratoi: L. Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar".